

Deklarate per Shtyp

07 tetor 2008

Nga: Denis Mujovic




6 - 9.11

Ne datat 6-9 nentor 2008, do te zhvillohet Festivali i Filmit te Europes Lindore, (The Eastern Neighbours Film Festival) i cili ka per qellim promovimin e filmave dhe kultures se vendeve te Europes lindore e jugore. Festivali permban nje program te zgjruar ku do perfshihen filma, filma me metrazh te shkurter dhe vizatimor si dhe dokumentare nga 14 vende te ndryshme. Keto filma do te ofrojnë nje prespektive origjinale te realitetit dhe kultures se ketij rajoni.

Realizem Magjik dhe Satire


Tradita e filmit te vendeve europiano-lindore eshte e mirenjohur per estetiken e saj te vecante e cila pershkruhet si realizem magjik apo realizem poetik. Elemente te tjere qe spikasin jane edhe sarkazma dhe humori shpotites ndaj vetes. Gjenerata e re e regjizoreve i dha nje interpretim te fresket kultures se artit skenik. Suksesin e tyre e vertetojne dhe cmimet e fituara ne festivalet me prestigjoze te filmit si: Oscar, Tiger, Golden Bear dhe Golden Leopard awards.



Vecanti te programit

Edicioni i pare i **Eastern Neighbours** do te hapet me filmin *Fraulein* (*Gospodjica*) i regizores **Andrea Staka**. Aktorja kryesore, **Mirjana Karanovic**, nje ikon e kinematografise se ish-jugosllavise, do te perfaqesoj kete film. Nje tjeter figure e mirenjohur eshte dhe regizori **Lazar Stojanovic**, I cili do te jete i pranishem ne prezantimin e **Eastern Neighbours** ne Amsterdam (vijon me poshte) dhe do te prezantoj filmin e tij te ndaluar *Plastic Jesus* (1971); film per te cilin ne ate kohe ai u denua me tre vjet burg.

Pjesa me e madhe e filmave qe do te shfaqen ne kete festival filmi do te jene nje premiere per publikun e Hollandes.



Fragmente dhe ekstra

Me date 19 tetor do te shfaqet nje fragment i **Eastern Neighbours** gjate **Festivalit te Filmave internacional te Amsterdamit (International Amsterdam Film Festival)**.

Per me shume informacion mund te shkoni tek: www.iaff.nl

Me 26 tetor 2008, ne Utrecht te Hollandes , **Eastern Neighbours** do te organizoje NoLabel Festival, i cili ka per qellim promovimin e talenteve te reja ne fushen e artit skenik. Keta artist do te perfaqesojne Europen lindore me filmat e tyre me metrazh te shkurter. Per me teper per gjate ketij evenimenti nje ditore do te kete dhe muzike live nga grupi **Kabaalkan** si dhe dj's **Dubcovsky** dhe **Malik**. Per me shume informacion mund te shkoni tek: www.culturelezondagen.nl

Nje pjese e rendesishme e **Eastern Neighbours Film Festival** do te jene dhe debatet,Q&A's, muzika live dhe workshop-et e ndryshme

Staffi organizues

Eastern Neighbours Film Festival organizohet nga fondacioni Cultural Aid ne bashkepunim me NewGround Productions si dhe Louis Hartlooper Complex.

Fund i Deklarates per shtyp

Per me teper informacion, materiale vizive apo sygjerime ju lutem kontaktoni me:

Albana Lici

pr_marketing@easternneighbours.com

ose
Denis Mujovic
Director Eastern Neighbours Film Festival

E mail: director@easternneighbours.com

Telephone: +31 (0) 628577278

www.easternneighbours.com